

VENDIM
Nr. 55, datë 20.7.2018

PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME POLIÇAN

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, si dhe rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR-së nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan për licencim për efekt përfundimit të shtimit të kategorisë C, për largimin e ujërave të ndotura dhe ndryshimit të emrit të shoqërisë, Komisioni Kombëtar Rregullator

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan, me NUIS: J69102446I është licencuar për herë të fundit nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 7, datë 3.2.2017, “Për rinovim licence Ujësjiellës Poliçan”, me vlefshmëri 4-vjeçare deri në datën 2.2.2021;

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan, me anë të shkresës nr. 392 prot., të datës 28.6.2018, ka aplikuar pranë ERRU-së për licencim për arsye të shtimit të kategorisë C, për largimin e ujërave të ndotura;

- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan plotëson kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit për shtim të kategorisë C, për largimin e ujërave të ndotura, konkretisht:

- Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur i plotë.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan, me:

Drejtues ligjor : Klajdi Brahimi

Drejtues teknik : Klajdi Brahimi

2. Operatori sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Poliçan autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A: Për grumbullimin dhe shpër-ndarjen e ujit për konsum publik.

Kategoria C: Për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Poliçan;

4. Kjo licencë është e vlefshme deri më 2.2.2021.

5. Vendimet e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 7, datë 3.2.2017, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Poliçan” dhe nr. 23, datë 7.6.2017, “Për një ndryshim në vendimin nr. 7, datë 3.2.2017, ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës Poliçan’”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani